

**K O N T R A T E**  
**PER THEMELIMIN E SHOQERISE**  
**"A. S MOTORS " sh.p.k .**

E lidhur sot me date 26 Mars 2024 ndërmjet ortakeve:

1. Asel Behri shtetas shqiptar datëlindjes 13/0/8/1992 ,lindur ne Durres dhe banues ne Durres Shqiperi  
Dhe
2. Rigelsa Behri shtetase shqiptare e datëlindjes 10/05/1995 lindur ne Durres dhe banuese ne Durres Shqiperi

Te cilet vendosen

**NENI 1**

Te krijojë shoqërinë tregtare me Përgjegjësi te Kufizuar "A.S MOTORS " sh.p.k, e cila do te veproje ne përputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi, dispozitat e kësaj kontrate, me statutin bashkëngjitur kësaj kontrate, me ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" nr 9901 date 14.04.2008 dhe formalitetet qe duhen plotësuar ne te.

Kjo shoqëri do te emërtohet "A.S MOTORS " sh.p.k.

**NENI 2**

Shoqëria "A. S MOTORS " sh.p.k do te ketë Seline e saj ne Zona kadastrale 1031,nr.pasurise 158/8, Arapaj, rrethi Durres dhe do te ushtroje veprimtarinë e saj private për një periudhe kohore pa afat te caktuar.

**NENI 3**

Shoqëria do te ketë për objekt te veprimtarisë te saj ushtrimin e aktivitetit privat ne fushën e :

Import-export i automjeteve dhe pjesëve te kembimit,transport nderkombetar dhe kombëtar per vete dhe te trete.



#### NENI 4

Shoqëria mund të ndryshojë emërtimin, vendqëndrimin, selinë, kohëzgjatjen, pjesëmarrjen e kuotave, objektin e veprimtarisë së saj, me vendim të ortakeve sipas dispozitave ligjore në fuqi.

#### NENI 5

Për realizimin e objektivave të shoqërisë ortakët rane dakord të bashkojnë kapitalet e tyre me qëllim përsosjen e organizimit e zhvillimit të veprimtarisë. Kapitali themeltar i shoqërisë do të jete: 100.000 (njëqind mijë) leke të reja dhe është ndare midis ortakëve me kontributet si më poshtë vijon :

1. ASEL BEHRI	me 80 % të kuotave = ( 80. 000 leke)
2.RIGELSA BEHRI	me 20 % të kuotave = ( 20. 000 leke)

Të gjitha pjesët e kapitalit themeltar është nënshkruar dhe shlyer krejtësisht, pastaj janë ndare ndërmjet ortakut të vetëm si më sipër.

Çdo kuote i takon e drejta e një vote.

#### NENI 6

Kapitali i shoqërisë mund të shtohet ose të pakësohet sipas vendimeve që do të marrin ortakët, por në asnjë rast njeri ortak nuk mund të detyroje ortakët e tjerë të rrisin kuotën e tyre në kapitalin e shoqërisë. Në rast se kapitali i shoqërisë për shkak të humbjeve të vërtetuara në dokumentet financiare, rezulton me i vogël se gjysma e kapitalit themeltar, ortakët vendosin brenda tre muajve nga miratimi i llogarive të përcaktojnë këtë humbje mbi mundësinë e prishjes së parakohshme të shoqërisë. Në rast se prishja nuk shpallet, shoqëria zvogëlon kapitalin e saj me një vlerë jo më të vogël se ajo e humbjeve që kanë mbetur, pa mbuluar fondet rezerve.

#### NENI 7

Ortaku që ka ndërmend t'u shesë të tretëve kuota të kapitalit të tij, tërësisht apo pjesërisht, duhet të njoftojë me parë ortakët e tjerë të shoqërisë, të cilët kanë të drejtën e parablerjes qofte dhe në kushte të barabarta. Kjo e drejtë duhet ushtruar brenda 30 ditëve nga data e komunikimit. Për hollësi të mëtejshme ortakët do të referohen dispozitave të parashikuara në Ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" nr 9901 date 14.04.2008.

## NENI 8

Organet drejtuese te shoqërisë jane:

- Asambleja e ortakeve;
- Administratori .

Procedura për emërimin ne funksionet përkatëse dhe shkarkimin e tyre rregullohen sipas statutit te shoqërisë.

## NENI 9

Ortaket themelues te Shoqërisë kane zgjedhur si administratore te shoqërisë zotin **ASEL BEHRI**, datëlindja 13/0/8/1992 me karte identiteti nr. J20813075F

Administratoret zgjidhet për 5 vjet kohe me te drejte ripërtëritjeje

## NENI 10

Vendimet e Asamblesë janë te vlefshme ne se janë miratuar nga ortakët e saj sipas dispozitave te Ligjit Për Shoqëritë Tregtare ne lidhje me pjesëmarrjen dhe shumicën e votave sipas kuotave ne kapitalin themeltar për Asamblenë e Zakonshme dhe te Jashtëzakonshme. Mënyra e thirrjes se Asamblesë se Zakonshme dhe te Jashtëzakonshme, kompetencave te ortakeve dhe marrjes se vendimeve do te bazohet ne statutin e shoqërisë si dhe ne Ligjin "Për shoqëritë tregtare".

## NENI 11

Likuiditet dhe transaksionet financiare do te depozitohen ne bankat shqiptare dhe ne ato te huaja, ku shoqëria ka llogarite e saj rrjedhëse.

Për kapitalin themeltar te shoqërisë është hapur libri i llogarive ku do te shënohet kontributi i secilit ortak. Po kështu shoqëria ka dhe përdor dokumentacionin sipas kërkesave te ligjit për kontabilitetin si dhe gjithë kërkesave te tjera financiare, te domosdoshme për veprimtarinë normale te saj.

## NENI 12

Fitimi neto i realizuar nga shoqëria do te ndahet ndërmjet ortakeve ne përpjesëtim me kontributin e secilit ne kapitalin themeltar te shoqërisë, mbasi te jene likuiduar te gjitha detyrimet, dhe te jete hequr 5% qe do te futet ne fondin e rezervës ligjore deri ne përmbushjen e 1/10 te kapitalit te shoqërisë.

## NENI 13

Shoqëria fillon veprimtarinë e saj vetëm pasi te ketë marre autorizimin e organeve kompetente sipas legjislacionit ne fuqi.

#### NENI 14

Ortakët janë të detyruar të ruajnë karakterin sekret të dokumentacionit, të eksperiencës së shkëmbyer, të realizuar brenda veprimtarisë të shoqërisë.

#### NENI 15

Te gjitha mosmarrëveshjet që nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim do të paraqiten për zgjidhje në gjykatën kompetente shqiptare në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### NENI 16

Në rast zgjidhje të kontratës, Asambleja e Ortakeve përcakton mënyrën e likuidimit dhe emëron një ose më shumë likuidatorë sipas normave ligjore.

#### NENI 17

Kjo kontratë u përpilua në prani të dy ortakëve duke shprehur në të vullnetin e lire dhe të plote të tyre.


#### NENI 18

Kontrata u përpilua në tre dokumente origjinale me fuqi të barabartë secila, për t'u depozituar në QK.R, Degën Rajonale Tatimore, si dhe një kopje ruhet në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

Ortaku themelues dhe administratori, z. Asel Behri do të kryejë veprimet përkatëse për regjistrimin e kësaj shoqërie si person juridik pranë Q.K.R-se

Ortakët

Asel Behri

Asel Behri  


Rigelsa Behri

Rigelsa Behri  
